

AKT- THEMELIMI

I SHOQËRISË TREGËTARE ME PËRGJËGJËSI TË

KUFIZUAR

“BIG KASTRIOTI” Sh.p.k.

Midis:

1. Shoqëria “**BIGALB GROUP**” shpk. Person Juridik shqiptar i regjistruar si i tillë pranë Regjistrimit Tregëtar në QKR, pajisur me Nipt *L11521002M* dhe seli në *Tiranë, Vaqarr, Fshati Gropaj, Godina Tirana Cash & Carry, kati 2*. Me përfaqësuese Ligjore Znj. Elona Koshi, e bija e Tekiut, e dtl. 04.09.1986, e lindur në Gramsh dhe banuese në Tiranë, Rruga “3 Dëshmorët”, Yzberisht. Madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi (ID Card) Nr. 033400499 lëshuar më datë 06.06.2017.
2. **Znj Mirela Sulaj**, e bija e Nuredinit, e datëlindjes 25.06.1974 lindur në Patos dhe banuese në Fier, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi (ID Card) H45625016M lëshuar më datë 21.01.2016.

Në bazë të legjislacionit shqiptar kanë vendosur me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, marrëveshjen për themelimin e shoqërisë tregtare private, me përgjegjësi të kufizuar, të emërtuar “**BIG KASTRIOTI**” Sh.p.k. e cila do të rregullohet në mbështetje të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”; ligji Nr.9723 date 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar , si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe normave që vijnë:

Neni 1

Te themelojë një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “Big Kastrioti” Sh.p.k. “Big Kastrioti” Sh.p.k. është një subjekt juridik Shqiptar, të cilit i lind e drejta të ushtrrojë aktivitetin që nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). Shoqëria “Big Kastrioti” Sh.p.k. zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe me aktet e themelimit të saj.

Neni 2

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe përballon humbjet sipas ligjit.



Neni 3

Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqërisë do të jetë:

- Tregëtimin e artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve me pakicë si:
- Tregëtim artikuj të ndryshëm industrial;
- Tregëtim artikuj të ndryshëm ushqimore;
- Tregëtim artikuj të ndryshëm bujqësore e blegtorale;
- Tregëtim fruta – perime;
- Tregëtim pije alkolike të ndryshme;
- Tregëtim konfeksione të ndryshme për të rritur dhe fëmijë;
- Tregëtim prodhimesh kozmetike e estetike;
- Tregëtim mallrash të të gjitha llojeve Brenda dhe jashtë vendit;
- Tregëtim automjeteve të cdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjesë këmbimi për to;
- Tregëtim, montim, riparim paisjesh elektro-shtëpiake, elektronike, elektrike, kompjuterike, higjeno-sanitare dhe hidraulike, prodhime qeramike, artizanati, paisje zyrash etj;
- Hapje dhe shfrytëzim hotelesh, motelesh, diskotekash, bar-kafe, lojra argëtuese për fëmijë, qendër sportive, qendra pushimi e kurative;
- Tregëtimin e karburanteve të ndryshëm me pakicë, si dhe vajrave lubrifikante, të gazit të lëngshëm për ngrohje, pajisje ngrohëse gazi si dhe mbushjen e bombolave të gazit dhe tregëtimin e tyre me pakicë.
- Tregëtimin e artikujve të ndryshëm kancelarik, libra, revista etj

Neni 4

- Shoqëria “Big Kastrioti” Sh.p.k. ka selinë e saj në adresën: *"Lagja Kastriot, Rruga Llambi Bego, Pallati nr. 7, Zona Kadastrale 8534, Nr. Pas. 4/12-N1, pranë Muzeut Historik, Fier "*

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqërisë “Big Kastrioti” Sh.p.k. do të jetë **17.000.000 (shtatëmbëdhjetë milionë)** lekë dhe është i përbërë nga shuma në të holla e derdhur nga ortakët.

Neni 6

Palët kontraktuese kanë rënë dakort të përcaktojnë kuotën e pjesmarrjes të secilit ortak si më poshtë:

Emri	Kuota	Përqindja	Kontributi në lekë
BIGALB GROUP	1	51%	8.670.000 Lekë
MIRELA SULAJ	1	49%	8.330.000 Lekë

Neni 7

Kohëzgjatja e shoqërisë “Big Kastrioti” Sh.p.k. do të jetë me afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 8

I gjithë kapitali i vënë nga të dy ortakët themelues është tërësisht dhe plotësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm nga ana e tyre.

Neni 9

Në librin e llogarisë që do të krijohet në Shoqërinë Tregëtare do të shënohet dhe kapitali i derdhur nga të dy ortakët. Rritja e kapitalit themelor të shoqërisë nuk është e kufizuar.

Neni 10

Të ardhurat e realizuara nga shoqëria do të ndahen pjesërisht ose totalisht ndërmjet ortakëve sipas kuotave të tyre të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar si dhe nëpërmjet akteve të tjera noteriale apo kontratave të punës që ata do të realizojnë, pasi të jetë lënë një shumë mënjanë të paktën sa një e njëzeta e tij e cila destinohet për formimin e fondit rezervë.

Neni 11

Ne kohën e prishjes së shoqërisë ose të përfundimit të afatit, kur nuk ka zgjatje afati kapitali i shoqërisë pasi të hiqen debitë e saj do të ndahet proporcionalisht ndërmjet ortakëve sipas kuotave të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar.

Neni 12

Fitimi i realizuar nga veprimtaria ekonomike e shoqërisë, pas shlyerjes së detyrimeve ligjore dhe ato që kanë lindur me të tretët, është plotësisht i transferueshëm dhe për tu depozituar në një nga Bankat Shqiptare, ose për tu përdorur sipas nevojave të ortakëve të shoqërisë.

Neni 13

Ortakët kanë këto të drejta dhe detyra themelore:

- të derdhin kuotën e kapitalit bazë sikundër është përcaktuar në nenin 6,
- të marrin pjesë në drejtimin e shoqërisë,
- të tërheqin fitimin e realizuar,
- të tërheqin aktivin resultant nga bilanci i likuidimit në rast të pushimit të aktivitetit të shoqërisë,
- të ruajnë sekretin e aktivitetit të shoqërisë,
- të impenjohen për arritjen e objektivave të shoqërisë.



Neni 14

Organet e shoqërisë “Big Kastrioti” Sh.p.k. janë:

- Asambleja e Ortakëve të shoqërisë
- Administratori i shoqërisë.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në statutin e shoqërisë Administrator i shoqërisë do të jetë Znj. Mirela Sulaj për një afat 5 vjeçar.

Neni 15

Shoqëria tregëtare private “Big Kastrioti” Sh.p.k. është person juridik shqiptar dhe do të ushtrojë veprimtarinë e saj ekonomike private në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe veçanërisht ligji 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” si dhe ligji Nr.9723 date 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, të K. Civil si dhe të akteve ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tyre.

Neni 16

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit, që lidhet midis palëve në mbështetje të ligjit Nr.7961, date 12.07.1995 (KODIT TË PUNËS), si dhe akteve të tjera në zbatim të tij.

Neni 17

Mosmarrëveshjet e mundëshme që mund të lindin gjatë interpretimit apo zbatimit të kësaj kontrate palët do t'i zgjidhin në rrugë miqësore, në të kundërt kompetencat për zgjidhjen e konfliktit i kalon Gjykatës së Rrethit Gjyqësor përkatës.

Neni 18

Për sa nuk përshkruhet në këtë kontratë themelimi do të aplikohen nenet e statutit të shoqërisë dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Neni 19

Ky Akt-themelimi është përpiluar në tre kopje origjinale.

Datë 17 / 07 / 2023

ORTAKËT THEMELUES

Shoq. “BIGALB GROUP” Sh.p.k.
Z. Vullnet Sinaj
Person i Besuar
Zj. Elona Koshi



Znj. Mirela Sulaj

Mirela Sulaj